

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19, paragrafi (1), pika 2) e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga GEN energija d.o.o., me seli në rrugën Vrbina 17, 8270 Krshko, Republika e Sllovenisë, dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Polenak, avokat Metodija Velkov nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 05.05.2025, mori këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin GEN energija d.o.o., me seli në rrugën Vrbina 17, 8270 Krshko, Republika e Sllovenisë, drejtpërdrejt dhe tërthorazi përmes shoqërisë së saj të lidhur Savske elektrarne Ljubana d.o.o. me seli në Gorenjska cesta 46, 1215 Medvode, Republika e Sllovenisë, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Gorenjske elektrarne, d.o.o., me seli në Stara cesta 3, 4000 Kranj, Republika e Sllovenisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19, paragrafi (1), pika 2) e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në vlerë prej 6.000,00 denarë dhe për vendimin në vlerë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 04.04.2025, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga GEN energija d.o.o., me seli në rrugën Vrbina 17, 8270 Krshko, Republika e Sllovenisë, me të cilin GEN energija d.o.o., drejtpërdrejt dhe tërthorazi përmes shoqërisë së saj të lidhur Savske elektrarne Ljubljana d.o.o. me seli në Gorenjska cesta 46, 1215 Medvode, Republika e Sllovenisë, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Gorenjske elektrarne, d.o.o., me seli në Stara cesta 3, 4000 Kranj, Republika e Sllovenisë, përmes blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimin të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe anekset e tij, konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Veprimtaria kryesore e shoqërisë **GEN energija d.o.o.** është menaxhimi i shoqërive të tjera juridikisht të pavarura (veprimtari të shoqërive holding). GEN energija d.o.o. është shoqëria udhëheqëse e Grupit GEN.

Si shoqëri holding, GEN energija d.o.o. kryen aktivitete menaxhimi bazuar në interesat pronësore në shoqëritë e lidhura dhe subjektet e kontrolluara bashkërisht, përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e përgjithshme, menaxhimit të rezultateve financiare të filialeve, miratimit të dokumenteve të nevojshme dhe emërimit të përfaqësuesve të saj në këshillat mbikëqyrëse të filialeve dhe subjekteve të kontrolluara bashkërisht.

Grupi GEN prodhon energji elektrike nga burime të rinovueshme me karbon të ulët, siç janë: energjia bërthamore, hidroenergja dhe energjia diellore.

Grupi GEN tregton në mënyrë efikase energjinë elektrike, duke u mundësuar konsumatorëve të marrin një shërbim cilësor në formën e furnizimit gjithëpërfshirës me energji elektrike dhe të kenë qasje në kanale të optimizuara të blerjes.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi GEN ka 3 (tri) shoqëri të lidhura të regjistruara:

- Shoqëria për shitjen e energjisë GEN-I PRODAZHBA NA ENERGIJA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 15A, Shkup – Qendër, Maqedonia e Veriut, me veprimtari të regjistruar: tregtimi i energjisë elektrike;
- Shoqëria për prodhimin e energjisë elektrike GEN-I SONCE SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 15 A/1, Shkup – Qendër, Maqedonia e Veriut, me veprimtari të regjistruar: prodhimi i energjisë elektrike dhe
- Shoqëria për prodhim dhe tregtim të energjisë elektrike GEN-I KAV SONCE SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 15 A/1, Shkup – Qendër, Maqedonia e Veriut, me veprimtari të regjistruar: prodhimi i energjisë elektrike.

Savske elektrarne Lublana d.o.o. është pjesë e Grupit GEN. GEN energija d.o.o. ka 100% pjesëmarrje në Savske elektrarne Lublana d.o.o.

Veprimtaria kryesore e Savske elektrarne Lublana d.o.o. është prodhimi i energjisë elektrike në hidrocentrale dhe operon me disa hidrocentrale. HE Zavrshnica është hidrocentrali më i vjetër i shoqërisë, që funksionon që nga viti 1914. Përveç këtij hidrocentrali, shoqëria operon edhe me hidrocentralet: HE Moste, HE Mavčiçe, HE Medvode dhe HE Vrhovo.

Veprimtaria kryesore e shoqërisë **Gorenjske elektrarne d.o.o.** është prodhimi i energjisë elektrike në hidrocentrale, centrale diellore dhe prodhimi i energjisë Aktiviteti kryesor i kompanisë Gorenjske elektrarne d.o.o. është prodhimi i energjisë elektrike në hidrocentrale, termocentrale diellore dhe prodhimi i energjisë në prodhim të kombinuar me efikasitet të lartë..

Gorenjske elektrarne d.o.o. nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pika 6 b) e Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ para Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

М-р Малинка Силјановска Николиќ